

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit P. Ll nga fsh. V. K-Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.1003/18 të datës 29.08.2018 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë **25.01.2019**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë – Prokurorit Ismet Tofaj, , të dëmtuarës M. Sh. dhe të akuzuarit mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari **P. LL nga fsh V. K Gjakovë**, i biri i M. dhe i nënës L. e gjinisë Q. , data e lindjes ... , ka te kryer shkollim universitar, zyrtar policor ,i gjendjes se mesme ekonomike ,shqiptar ,shtetas i R. Kosovës ,i martuar ,atë i 3 fëmijëve , me nr. ID

Është fajtor

Sepse:

- **me datë 11.05.2018, rreth orës 08:40/h në Gjakovë**, në rrugën Gjakovë- Klinë, duke drejtuar automjetin e markës “...” me tar. të regjistrimit ..-.-., ngjyrë hiri , pronë e L.Ll nga fsh. V. K-Gjakovë, nuk u përmbahet kufizimeve , ndalimeve dhe obligimeve të shprehur përmes shenjave të trafikut , e nuk respekton përparësinë e kalimit , e vepron në kundërshtim me nenin 13 par. 6/4 e lidhur me nenin 61 par. 5/1 të Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor , ashtu që rrezikon trafikun publik , jetën e njerëzve e pasurin, nga pakujdesia , edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mos veprimi i tij , e me mendje lehtësi mendon se nuk do të shkaktohet , ose do e parandaloj dhe pasoja është shkaktuar , në atë mënyrë që me të arritur me automjet në kryqëzimin e fsh.V. K- Gjakovë , duke mos respektuar shenjën “Stop” dhe përparësinë e kalimit të automjeteve me përparësi kalimi , nxiton e ndërmerr veprim që të kyçet në rrugën kryesore Klinë-Gjakovë , e me pjesën e parë anësore të djathtë në pjesën e parë ballore të majtë e godet automjetin e markës “...” me tar. të regjistrimit ..-.-. ngjyrë e argjend ,pronë e K. Ll. nga Gjakova, Rr.” ..., i cili ishte duke qarkulluar në rrugën kryesore , e dëmton automjetin të cilin e drejtonte e pa lëndime trupore, ndërsa të dëmtuarës M. H. Sh. nga fsh. ... K-Gjakovë, i shkakton dëme material në automjet dhe lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. D. H. të dt. 29.08.2018.

- **me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-ës .**

Gjykata ne baze te nenit 4,41,85,86 par. 1,3 dhe 5 dhe nenit 378/6-1 te KPRK-ës dhe nenit 365 te KPPK-së, të akuzuarës i shqipton :

VËREJTJE GJYQËSORE

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **71,10-€**(në emër të ekspertizës mjeko-ligjore dhe ekspertizës së komunikacionit) si dhe në emër të

paushallit gjyqësor ne shumë prej **20.00.-€**, në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me Aktakuzën PP.nr.588/2018 të datës 16.07.2018, e ka akuzuar të akuzuarin P. Ll nga fsh. ...,K- Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 25.03.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë, Prokurori Ismet Tofaj, pasi lexon aktakuzën PP.nr.1003/18 të datës 29.08.2018 deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari P. Ll, gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. A. H., e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer nga pakujdesia, kërkojë faljen nga e dëmtuara për lëndimet e marra ,andaj i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur në gjykatë për veprën e kryer , kërkim falje nga e dëmtuara , premtimi se në të ardhmen nuk do ta përsërisë ndonjë vepër penale apo të ngjashme , si dhe faktin se është hera e parë që kam ra në ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

E dëmtuara M. Sh. , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale me qenë se me të njëjtin sipas traditave jemi pajtuar pasi që kjo vepër nuk është kryer me dashje por nga pakujdesi e po ashtu kam realizuar kompensimin e dëmit nga kompania e sigurimeve në tërësi

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshme për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë, dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lendes, dhe se nga këto prova vërtetohet edhe gjendja faktike në aktakuzë dhe përmbushen të gjitha elemente të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari P. Ll: - **me datë 11.05.2018, rreth orës 08:40/h në Gjakovë**, në rrugën Gjakovë- Klinë, duke drejtuar automjetin e markës “ ...” me tar. të regjistrimit ..-.., ngjyrë hiri , pronë e Ll.Ll nga fsh. V. K-Gjakovë, nuk u përmbahet kufizimeve , ndalimeve dhe obligimeve të shprehur përmes shenjave të trafikut , e nuk respekton përparësinë e kalimit , e vepron në kundërshtim me nenin 13 par. 6/4 e lidhur me nenin 61 par. 5/1 të Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor , ashtu që rrezikon trafikun publik , jetën e njerëzve e pasurin, nga pakujdesia , edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mos veprimi i tij , e me mendje lehtësi mendon se nuk do të shkaktohet , ose do e parandaloj dhe pasoja është shkaktuar , në atë mënyrë që me të arritur me automjet në kryqëzimin e fsh.... K- Gjakovë , duke mos respektuar shenjën “Stop” dhe përparësinë e kalimit të automjeteve me përparësi kalimi , nxiton e ndërmerr veprim që të kyçet në rrugën kryesore Klinë-Gjakovë , e me pjesën e parë anësore të djathtë në pjesën e parë ballore të majtë e godet automjetin e markës “ ...” me tar. të regjistrimit ..-..-.. ngjyrë e argjend ,pronë e K. Ll. nga Gjakova, Rr.” ..., i cili ishte duke

qarkulluar në rrugën kryesore , e dëmton automjetin të cilin e drejtonte e pa lëndime trupore, ndërsa të dëmtuarës M. H. Sh. nga fsh. ... K-Gjakovë, i shkakton dëme material në automjet dhe lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. D. H. të dt. 29.08.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë , dhe është bindur se pranimitin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh pranimitin e fajësisë nga i akuzuari, personalitetin e tij se është baba i tre fëmijëve , kërkim faljen nga e dëmtuara, sjelljen korrekte e të akuzuarit në gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, deklarimi i dëmtuarës se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale meqenëse janë pajtuar sipas traditave dhe zakoneve dhe nuk kërkon kompensim dëmi meqenëse të njëjtin e ka realizuar si dhe faktin se është hera e parë që bie në ndesh me ligjin. Nisur nga të gjitha këto Gjykata i shqiptoi **vërejtje gjyqësore**, me bindje se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, pra, me vërejtje gjyqësore do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesë pasurore juridike , ngase e dëmtuara M. Sh. gjatë shqyrtimit fillestar nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor , është marrë komfor nenit 450 par.1dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P. nr. 600/18 dt. 25.03.2019.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej **15 dite**, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë ,

nëpërmjet të kësaj Gjykate